REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARTA GJ. PJETËRNIKAJ
ADRESA NR.9, DERVISH HATIXHE,
NR.64, NR.1, NR.1
TEL: 0672029096

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 6614** **Nr. koleksioni: 2173**

**Tirane më 23/12/2021**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2021052690240861473

A2021052690240861473

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI**

***( TË SHOQËRISË "DAAM" SH.P.K. )***

Sot, më datë 23.12.2021, para meje Notere ARTA GJ. PJETËRNIKAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.9, DERVISH HATIXHE, NR.64, NR.1, NR.1, u paraqiten personalisht:

**SHITES**: Brunilda Buli, atësia Jovan, amësia Athina, shtetase Shqiptare, lindur në Kavajë, Durrës dhe banuese në TIRANË, me adresë Frosina Plaku; Nd. 21; H. 21; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 05/10/1985, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034669001 dhe nr. personal I56005089R.

**BLERES**: Valter Begaj, atësia Nimet, amësia Behare, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në TIRANË, me adresë E Dibrës; Nd. 10; H. 22; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 8; Njësia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 09/11/1972, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036603303 dhe nr. personal H21109086G.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "DAAM" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

***TE DHENA PARAPRAKE***

1.Znj. Brunilda Buli eshte ortak i 1 (nje) kuote me pjesemarrje ne kapital me 100% te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqernie "DAAM" shpk.
Ne baze te vendimit te Asamblese se Ortakut te ,vetem te Shoqerise "DAAM" shpk, ajo ka vendosur te behet shitja e 100% te kuotave te kapitalit qe Znj. Brunilda Buli zoteron te Shoqerise "DAAM" shpk, tek bleresi Valter Begaj.

2.Bleresi behet ortak i vetem i shoqerise "DAAM" shpk , zoterues i 1 (nje) kuote me pjesemarrje ne kapital ne masen 100% te kapitalit.

3.Ne baze te Udhezimit nr. 2007/1, date 2.3.2010, te Ministrit te Drejtesise dhe Ministrise se Ekonomise, Tregtise dbe Energjetikes eshte kerkuar informacion nga noteri sipas njoftimit D prane Regjistrit te Barreve Siguruese dhe nga pergjigjja e dhene nga RBS, rezulton se mbi kuotat e kapitalit themeltar te Shoqerise "DAAM" shpk nuk rezulton asnje barre siguruese.

NENI 1
Objekti

Objekti i kesaj kontrate eshte shitja e kuotave te kapitalit nga shitesi tek bleresi kundrejt cmimit te percaktuar ne neni 2 te kesaj kontrate.

A2021052690240861473

## NENI 2
## Cmimi

2.1 Shitesja Brunilda Buli deklaron se i shet bleresit Valter Begaj gjithe kuoten qe ajo zoteron,me pjesemarrje ne masen 100 % te kapitalit te shoqerise kundrejt cmimit te sitjes ***200.000.000,00 ( dyqind milion) leke*** të rinj. Kjo vlere do te paguhet nga bleresi ne llogarine bankare te shitesit dhe mandatet do t'i bashkangjiten kesaj kontrate. Palet deklarojne se cmimi eshte i vetem, i pandryshuar dhe palet nuk kane asnje pretendim ndaj njeri tjetrit ne lidhje me vleren dhe menyren e likujdimit si me poshte pershkruar.

2.2 Cmimi i shitjes se kuotave te kapitalit do te paguhet me keste brenda nje periudhe kohore prej 3 (tre) vitesh nga dita e nenshkrimit te kesaj kontrate. Nese pala blerese nuk paguan vleren totale te cmimit te shitjes se kuotave te kapitalit brenda 3 vjetesh, shoqeria do t'i kthehet shitesit, pronarit, pa asnje detyrim shtese.

## NENI 3
## Kalimi i Pronesise

Me nenshkrimin e kontrates se shitjes se kuotave te kapitalit brenda afateve te normuara me ligj dhe me regjistrimin e saj ne zyrat e QKB-se, bleresit i kalon pronesia mbi kuoten e blere menjehere,e lire dhe pa barre dhe ai do te njihet ortak i vetem i shoqerise.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitesja, Brunilda Buli zhvishet nga e drejta e pronesise mbi kuotat e kapitalit te shoqerise "DAAM" shpk dhe bleresi, Valter Begaj behet pronar i 1 (nje) kuote te kapitalit te shoqerise me pjesemarrje 100% te kuotave te Shoqerise "DAAM" shpk dhe do t ejete administrator i shoqerise. Bleresi do te beje te gjitha veprimet perkatese prane organeve kompetente.

## NENI 4
## Te ndryshme

4.1 Palet u porositen qe te depozitojne kontraten prane Qendres Kombetare te Biznesit per te bere regjistrimet perkatese;

4.2 Kjo kontrate eshte hartuar ne baze te legjislacionit shqiptar dhe konkretisht te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"; dhe Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Ceshtjet qe kjo kontrate nuk i rregullon shprehimisht do te rregullohen nga dispozicat e Kodit Civil;

4.3 Cdo mosmarreveshje qe mund te lind nga interpretimi ose zbatimi i kushteve te kesaj kontrate do te zgjidhen me bisedime dhe me mirekuptim te ndersjellte midis paleve ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Ne rast se mosmarreveshjet nuk zgjidhen me mirekuptim do te drejtohen ne organet kompetente per zgjidhjen e tyre, ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane.

## NENI 5

## DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

5.1. Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

5.2. Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

A2021052690240861473

5.3. Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALËT KONTRAKTUESE**

**SHITES**

Znj. Brunilda Buli

**BLERES**

Z. Valter Begaj

**NOTER**

ARTA GJ. PJETËRNIKAJ

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

Regjistri i Barrëve Siguruese

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-202112221774782 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 22.12.2021 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 5:07:04PM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-599-1293 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

BRUNILDA JOVAN BULI
DAAM SH.P.K.

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANE - ALBANIA